



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1956, datë 24.05.2012

Për

“Miratimin për këshillim publik të projekt rregullores “ Mbi publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro Xhixho Kryetar
2. Znj. Alketa Mukavelati Anëtare
3. Z. Alban Karapici Anëtar
4. Z. Benon Paloka Anëtar
5. Znj. Zamira Nurçe Anëtare

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 24.05.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim relacionin shpjegues të Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin Nr.794, datë 18.01.2012, dhe diskutoi materialin e përgatitur:

- Memo e Grupit të Punës; (**Memoja**)
- Relacioni shpjegues i Projekt - Rregullores; (**Relacioni**)
- Projektvendim i Këshillit Drejtues; (**Projekt vendimi**)
- Projekt rregullore “Mbi publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut; (**projekt-akt**)

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7, neni 98, neni 110 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

2. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

KESHILLI DREJTUES:

Nga diskutimi gjatë mbledhjes duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

Grupi i Punës ka përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim në Këshillin Drejtues projekt -dokumentin rregullator për “Publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut”.

Projekt-akti i përgatitur është mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullator të AKEP.

PER KETO ARSYE :

Me qëllim që palët me interes të njihen me këtë projekt - akt të rëndësishëm rregullator si dhe të kontribuojnë duke paraqitur mendimet dhe komentet e tyre me shkrim mbi to,

KESHILLI DREJTUES:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP,

V E N D O S I :

1. Të publikoje për keshillim publik projekt dokumentin “ Mbi publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut”.
2. Afati i këshillimit publik është 30 ditë nga data e miratimit të këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

**Mbi publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve
elektronike në dispozicion të publikut**

Përmbajtja e rregullores

- I. Dispozita të Përgjithshme**
- II. Parimet e përgjithshme të publikimit të tarifave**
- III. Rregullat e publikimit të tarifave**
- IV. Dispozitat përfundimtare dhe masat administrative**

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllim i kësaj rregulloreje është të përcaktojë llojin dhe përmbajtjen e informacionit, që sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (referuar këtu e tutje me termin “Sipërmarrës/i/it/in/ve”) janë të detyruar të publikojnë për tarifën, cilësinë dhe kushtet e përgjithshme për aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Neni 2

Baza ligjore

Nenet 54, 98 dhe 102 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Përcaktimet e kësaj rregulloreje janë të detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjithë sipërmarrësit e autorizuar të ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike në Republikën e Shqipërisë.

KREU II

PARIMET E PERGJITHSHME TE PUBLIKIMIT TE TARIFAVE

Neni 4

Kërkesa të përgjithshme për publikimin e tarifave

Sipërmarrësit janë të detyruar të publikojnë informacion për tarifën, cilësinë dhe kushtet e përgjithshme për aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

Neni 5

Parimet e përgjithshme të publikimit të tarifave

Për të siguruar transparencën në publikimin e tarifave për publikun nga ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të zbatohen parimet e mëposhtme:

- a. **Informacioni mbi publikimin e tarifave duhet të jetë i saktë.** Sipërmarrësi duhet të sigurojë saktësinë e informacionit për tarifën që publikon. Tarifën e publikuar duhet të jenë saktësisht të njëjta me tarifën e aplikuar për faturimin e përdoruesit. Sipërmarrësit duhet të përdorin procedurën të saktë në përcaktimin e tarifave që do të publikojnë (me aq

shifra pas presjes dhjetore sa ti afrohet numrit real) me qëllim që të mos krijohen keqkuptime midis konkurentëve dhe të krijojë lehtësi krahasimi nga përdoruesit.

- b. **Informacioni mbi publikimin e tarifave duhet të jetë i hollësishëm.** Sipërmarrësi duhet të publikojë informacion të hollësishëm që të përmbajë opsione të ndryshme tarifore. Publikimet e tarifave duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat duke përfshirë dhe pagesat shtesë, pagesat minimale për raste të veçanta, kohën me fluksin më të madh, kohën pa fluks, kushte rreth kohës së përdorimit dhe opsionet shtesë. Publikimi i tarifave nga sipërmarrësi duhet të bëhet me mjetet e informimit publik: TV, radio, shtypin e përditshëm, internet etj., në të cilat sipërmarrësi duhet të tregojë vendin ku përdoruesit mund të gjejnë të gjithë informacionin e plotë e të hollësishëm të shërbimeve dhe tarifave.
- c. **Informacioni mbi tarifën duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm.** Sipërmarrësit duhet të publikojnë një informacionin mbi tarifën që të jetë i qartë, i kuptueshëm, lehtësisht për tu gjetur duke përfshirë të gjithë informacionin për llojet dhe kushtet e shërbimeve, ofrimin e shërbimeve falas, tarifën speciale të shërbimeve e tjera. Informacioni për tarifën duhet t'i jepet përdoruesit përpara se ti ofrohet shërbimi.
- d. **Informacioni mbi tarifën duhet të jetë i plotë.** Tarifën për të gjitha shërbimet që ofrohen duhet të publikohen të plota nga Sipërmarrësit. Kjo do të thotë që tarifa që publikohet duhet të përfshijë TVSH-në, apo detyrime të tjera ndaj shtetit, dhe duhet të paraqiten të gjitha elementet që përmban një program tarifor.

Neni 6

Lloji dhe përmbajtja e informacionit

Me qëllim që të garantohet një paraqitje e plotë dhe cilësore e programeve tarifore, gjë e cila do t'ju mundësojë përdoruesve krahasimin mes programeve të ndryshme, si më poshtë:

Sipërmarrësit kanë detyrimin të publikojnë dhe bëjnë të disponueshëm informacionin e mëposhtëm:

a) Identifikimi i sipërmarrësit/ofruesit

Sipërmarrësi ka detyrim të publikojë dhe të deklarojë qartë:

1. Emrin e tij
2. Formën ligjore
3. Adresën zyrtare dhe elektronike
4. Numrin e regjistrimit në QKR

Me qëllim rritjen e transparencës, rekomandohet që të publikohen gjithashtu:

5. Numrat e telefonit të kujdesit ndaj klientit;
6. Adresa e-mailit dhe faqja e Internetit

b) Shërbimet e ofruara

Sipërmarrësi duhet të publikojë informacionin e mëposhtëm:

1. Përshkrimi i shërbimeve të ofruara, si dhe shërbimeve e lehtësive shoqëruese:

Sipërmarrësit që ofrojnë shërbim publik telefonik, të lëvizshëm dhe fiks duhet të informojnë gjithashtu:

- Mundësinë e kryerjes dhe marrjes së thirrjeve (dalëse dhe hyrëse) kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aksesin në shërbimet e emergjencës (mundësia për të marrë në telefon numrat e emergjencës)¹;
- Identifikimi i linjës së palës thirrëse dhe palës së thirrur;
- Shërbimin e operatorit
- Numerator telefonik nga operatori (i printuar ose elektronik) për abonentët e vet;
- Shërbimi i informacionit për numrat (kërkimit të informacionit) në numerator
- Pengesa selektive e thirrjeve
- Mundësinë e përdorimit të ofruesve alternative të thirrjeve telefonike si karta me parapagim (OSHKP), Z(P)B;
- Aksesin në shërbimet me numra jogjeografikë
- Ofrimin e telefonave publikë me pagesë;
- Shërbimet në kushte të veçanta, sipas përcaktimeve në pikën 3 të nenit 27 të ligjit 9918;
- Ofrimin e pajisjeve fundore të veçanta të telekomunikacioneve për konsumatorë me aftësi të kufizuara ose nevoja sociale të veçanta;
- Roaming ndërkombëtar (për shërbimin celular):
 - o Në cilat vende ofrohet roaming ndërkombëtar
 - o Mënyrën e aktivizimit të shërbimit roaming dhe tarifat përkatëse
 - o Këshilla për përzgjedhjen automatike dhe manuale të rrjetit gjatë kohës në roaming,
 - o Këshilla për të shmangur roamingun e padëshiruar në territorin e RSH, duke dhënë edhe informacion për vendet gjeografike të mundshme ku mund të ndodhë ky fenomen;
 - o Këshilla për abonentin për përdorimin e aparatit telefonik gjatë kohës së qëndrimit në shtet të huaj për të shmangur fatura tepër të larta gjatë kohës në roaming ndërkombëtar (përfshirë këshilla për të kontaktuar operatorin nëse fatura është tepër e lartë për shkak të roamingut ndërkombëtar).

2. **Kufizime të mundshme të shërbimit**, që mund të vijnë nga:

- Nevoja për të përmbushur disa kushte teknike paraprakisht si pamundësia për akses në Internet nëse shërbime të caktuara telefonike janë të zëna;
- Nevojën për të zotëruar aparate të caktuara telefonike për përfitim të shërbimit,
- Pamundësia për të kryer thirrje me Z(P)B drejt numrave të caktuar telefonikë

3. **Informacion mbi mbulimin geografik** të shërbimeve si edhe referencë për pikat e shitjes (adresat e tyre) ku përdoruesit mund të marrin informacion të përditësuar për zonat e mbulimit me shërbim dhe ofrimin e tyre;

Rekomandohet që operatori të publikojë hartë të mbulimit gjeografik të shërbimeve, me qëllim evidentimin e zonave gjeografike ku ofrohet apo nuk ofrohet shërbimi.

Operatorët celularë duhet:

- Të ofrojnë hartë të mbulimit me sinjal në territorin RSH për shërbimet 2G dhe 3G, duke evidentuar edhe zonat ku nuk ka sinjal.
- Të ofrojnë informacion për shtetet ku ofrohet roaming ndërkombëtar.
- Të ofrojnë hartë të mbulimit gjeografik.

¹ Përcaktimi në germën 'a' është kriter i detyrueshëm që një shërbim të konsiderohet shërbim publik telefonik i disponueshëm për publikun (pika 45 e nenit 3 të Ligjit 9918). Në rast se shërbimi i ofruar nuk krijon këto mundësi në germën 'a' ai nuk konsiderohet shërbim telefonik i disponueshëm për publikun.

c) Tarifat standarte që përfshijnë aksesin, të gjitha llojet e tarifave të përdorimit, mirëmbatjes, përfshirë detaje të zbritjeve standarte të aplikuarra si edhe skemat tarifore speciale dhe të targetuara.

Ky informacion ka për qëllim ti mundësoje konsumatorëve të percaktojnë se si tarifohet dhe faturohet shërbimi i ofruar. Për këtë arsye informacioni i mëposhtëm mbi tarifat konsiderohet i nevojshëm për tu publikuar:

1. Lloji dhe niveli i çmimeve të aplikueshme për shërbimin në fjalë, përfshirë:
 - Ndryshimet sipas destinacioneve gjeografike të tyre si thirrje lokale, rajonale, kombëtare nëse aplikohen
 - Çmimet për komunikim drejt llojeve të ndryshme numrash si thirrje brënda rrjetit, jashtë rrjetit, numrave jo-gjeografike.
2. Në veçanti për shërbimin publik telefonik të lëvizshëm duhet të paraqiten për çdo program tarifor, sipas rastit:
 - Programet tarifore të ndara sipas mënyrës së pagesës: parapagim, kontratë, hibrid;
 - Tarifa e regjistrimit (nëse ka të tillë).
 - Pajtimi mujor (mujor nëse ka të tillë);
 - Koha minimale fillestare e tarifimit dhe mënyra e tarifimit të kohës së thirrjes;
 - Garancitë kombëtare (nëse ka të tilla).
 - Minuta të përfshira (si brënda grupit, brënda rrjetit, kombëtare, ndërkombëtare etj).
 - SMS të përfshira (si brënda grupit, brënda rrjetit, kombëtare, ndërkombëtare etj).
 - Internet i përfshirë i shprehur në njësi (KB, MB etj.).
 - Tarifa e thirrjeve të detajuara sipas destinacionit, kohëzgjatjes etj.
 - Tarifat për roaming hyrës dhe dalës të detajuar sipas shteteve dhe operatorëve.
 - Publikimi i shërbimeve pa pagesë.
 - Çdo tarifë tjetër që është objekt i faturimit të përdoruesit.
3. Për shërbimin internet:
 - Tarifa e pajtimit mujor sipas shpejtësisë së transmetimit dhe limitit.
 - Tarifa e instalimit sipas shpejtësisë së transmetimit dhe limitit.
 - Tarifa për çdo njësi të harxhuar mbi limitin e përcaktuar në paketë.
 - Çdo tarifë tjetër që është objekt i faturimit të përdoruesit.
4. Kosto minimale e shërbimit, kur ajo nuk është e njëjtë me njësinë e përcaktuar tarifuese si dhe mënyra e tarifimit.
 - Koha minimale e tarifimit të thirrjeve dhe/ose tarifa për thirrje;
 - Njësia bazë e tarifimit dhe mënyra e tarifimit psh. për sekondë (apo bllok sekondash etj), për impulse, për bit/Mb etj.
5. Tarifat e instalimit, ri-instalimit dhe shkëputjes për shërbimin në fjalë, nëse aplikohet;
6. PAGESA minimale mujore, nëse aplikohet;
7. Në rastet kur programi tarifor ka pagesë fikse mujore duhet të jepen detaje:
 - Çfarë përfshihet në pagesën mujore si p.sh. minuta thirrje, SMS, MMS, kapacitet download dhe/ose upload;
 - Tarifat dhe mënyra e tarifimit pas kosnumit të komunikimeve të përfshira në pagesësn mujore;
 - PAGESA maksimale, nëse aplikohet.

8. Tarifat e mirëmbajtjes, nëse aplikohen, si edhe tarifa e komunikimit me shërbimet e kujdesit të klientit për raportimin e defekteve (nëse është falas duhet të specifikohet);
9. Tarifat e qerasë për pajisje, nëse aplikohet;
10. Kushtet për të ofrimin e zbritjeve, promocioneve dhe kreditim, nëse aplikohen
11. Brezat orare Peak dhe off-peak, nëse aplikohen, dhe çmimet përkthënë për këto breza orare;
12. Të gjitha çmimet e shërbimeve duhet të publikohen duke përfshirë vlerën e TVSH.

Në rastet kur një sipërmarrës ofron paketa të ndryshme tarifore për të njëjtin shërbim, rekomandohet që sipërmarrësi të bëjë të disponueshme simulatorë (interactive në faqen e Internetit dhe në dyqan) që mundësojnë krahasimin e paketave tarifore të ofruara prej tij për të dhënë një klasifikim të tyre sipas shpenzimeve të përdoruesit për çdo lloj profili përdoruesi.

d) Politikat e kompensimit dhe të rimbursimit, duke përfshirë detaje të skemave përkatëse kur këto ofrohen.

Sipërmarrësit duhet të parashikojnë dhe publikojnë skemat e kompensimit/rimbursimit në rastet e mos-repektimit të nivelit të treguesve të cilësisë së shërbimit të përcaktuar në kontratë.

e) Llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes së ofruar.

Sipërmarrësi duhet të japë informacion për shërbimet e mirëmbajtjes së ofruar si edhe detyrimet e marra përsipër për këto shërbime.

Gjithahshtu operatori ka detyrimin që të publikojë dhe japë informacionin e mëposhtëm:

- i) Informacion për shërbimet ndaj klientit për raportimin e defekteve, orarin raportimit dhe kostot përkatëse;
- ii) Niveli minimal i cilësisë i ofruar ndaj përdoruesit për kohën e riparimit të defekteve. Për këtë tregues operatori duhet të masë dhe publikojë treguesin c) në Aneksin e kësaj rregulloreje.

f) Kushtet e kontratës standart.

Termet dhe Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit (apo kontratat tip sipas nenit 99 të ligjit 9918) duhet të publikohen nga sipërmarrësi, përfshirë numrin e vendimit të AKEP që ka miratuar këto terma/kontratë tip.

g) Mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përfshirë ato të ofruara nga sipërmarrësi ofruar i shërbimit.

Në lidhje me këtë çështje, informacioni mbi mekanizmat gjyqësore dhe jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të publikohet dhe jepet, duke përfshirë procedurat e brendshme të zbatuara nga ana e kompanisë, në mënyrë që të bëjë të qartë për publikun, dhe posaçërisht për klientët, që keto mekanizma ekzistojnë dhe se si ato mund të aksesohen. Është e rekomanduar që informacioni i mëposhtëm të publikohet

1. Kanale në dispozicion për pranimin e ankesave, duke përfshirë edhe identifikimin e strukturës përgjegjëse brenda strukturës së kompanisë për trajtimin e ankesave;
2. Afati kohor për pranimin(dërgimin) e ankesave;
3. Afati për përgjigje të ankesave, në këtë kuadër, është sugjeruar që ofruesi të masë parametrin d) në Aneksin e kësaj rregulloreje;

4. Afatin pas të cilit, në mungesë të një vendimi për ankesën, ofruesi merr përsipër të kontaktoje klientin që ta informojë atë në lidhje me progresin e arritur për ceshtjen e ankimuar, dhe
5. opsion për pajtimatrin që të paraqesë mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kontratës për ne mekanizmat jahtegjyqesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe detajet përkatëse të kontaktit.

Neni 7

Forma e publikimit dhe dhënies së informacionit

1. Informacioni i parashikuar më sipër në nenin 6 duhet të publikohet dhe të jetë i qartë në mënyrë të shkruar:
 - a. Faqen e Internetit të sipërmarrësit.
Secili sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun duhet të zotërojë një faqe Interneti me domain .al.
 - b. Pikat e shitjes të veta, të agjentëve dhe/ose të distributorëve të tij, nëse aplikohet
 - c. Në zyrat e sipërmarrësit nëse këto përdoren edhe si pika shitje;
2. Informacioni i dhënë në faqen e internetit të sipërmarrësit duhet të jetë i qartë, i dukshëm, dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm, domethënë në të njëjtën faqe (seksion) ku publikohet shërbimi që ofrohet ose nëpërmjet një seti link-esh për këtë qëllim, me madhësi dhe prezantim grafik që të mundësojë identifikim të lehtë të tyre.
3. Ky informacion duhet të jepet pa pagesë dhe në mënyrë të shkruar në të gjitha pikat e shitjes. **Personeli në pikat e shitjes duhet të japë informacion të detajuar dhe sqarime për përdoruesit dhe të disponojë në formë të printuar (në formë fletë palosje) për çdo paketë tarifore të ofruara dhe ofertë/promocione në fuqi.**
4. Nëse përfitimi i shërbimit përfshin blerjen e një produkti të paketuar (si p.sh kartë SIM me parapagim apo karta me parapagim-OSHKP), produkti i paketuar duhet të përshijë:
 - a. Identifikimin e ofruesit të shërbimit
 - b. Përshkrimi i përgjithshme i shërbimit, duke deklaruar karakteristikat kryesore të tij;
 - c. Çmimet në lidhje me shërbimin bazë dhe,
 - d. Vendet (pika shitje dhe/ose faqe internet) ku mund të merret informacion për kushtet dhe të gjitha tarifat e tjera për ofrimin dhe përdorimin e shërbimit.
5. Për çdo ndryshim të kushteve të ofrimit të shërbimit, sipërmarrësi duhet të përditësojë informacionin e bërë të disponueshëm për publikun dhe përdoruesit, duke ndjekur detyrimet e kësaj rregulloreje.

KREU III

RREGULLAT E PUBLIKIMIT TE TARIFAVE

Neni 8

Detyrimi dhe rëndësia e publikimit të tarifave

Sipërmarrësi është i detyruar të publikojë tarifat me qëllim që përdoruesit të kenë mundësi njohjeje para kërkesës së përdoruesit për shërbimet që i ofrohen.

Neni 9

Detyrimi për informimin e AKEP

Sipërmarrësi janë të detyruar të paraqesin në AKEP, informacionin e publikimit për tarifave të shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre 7 ditë para hyrjes në fuqi të tyre. Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe shkresore

Neni 10

Publikimi i ofertave të veçanta

Sipërmarrësi është i detyruar që në publikimin e tarifave të paraqesë datën e publikimit dhe datën e hyrjes në fuqi të tarifave të ndryshuara. Për tarifave dhe kushtet e tjera të ofertave që janë të vlefshme për një periudhë të kufizuar kohe, sipërmarrësi duhet të publikojë datën e hyrjes në fuqi dhe datën e mbarimit të afatit së ofertës.

Neni 11

Detyrimi për publikimin elektronik

Sipërmarrësit janë të detyruar të publikojnë në faqen e tyre të internetit pa pagesë informacionet mbi tarifave duke përfshirë dhe opsione e detaje për ulje çmimi, skema tarifore speciale apo kushte të tjera të favorshme që ofrohen.

Neni 12

Detyrimi për saktësinë e informacionit

Sipërmarrësi duhet të evitojë manipulimin e informacionit të publikimit të tarifave që mund të çojnë në cenimin e interesave të përdoruesit. Sipërmarrësit duhet që tarifave që publikohen t'i kenë të sakta dhe rrumbullakosja e tyre për njësi të bëhet me aq shifra pas presjes dhjetore aq sa numri t'i afrohet sa më shumë shifrës reale.

Neni 13

Detyrimi për mbajtjen e evidencave dhe dërgimin e tyre në AKEP

Sipërmarrësit që ofronë shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun janë të detyruar të mbajnë evidencë të detajuar të publikimit të çdo ndryshimi të tarifave të shërbimit dhe të jenë të gatshëm në çdo kohë t'i paraqesin sa herë që kërkohet nga AKEP. Evidenca e detajuar e publikimit të tarifave dhe ndryshimeve të bëra do të mbahet për një periudhë një vjeçare nga data e informacionit të tarifave të paraqitur në AKEP.

Neni 14

Publikimi i tarifave në faqen elektronike të AKEP

AKEP, analizon dhe bën vlerësimin e përgjithshëm të tarifave aktuale, të disponueshme për publikun me qëllim publikimin e tyre në një seksion të veçantë në faqen elektronike: www.akep.al. Për publikimin e tarifave në faqen elektronike, AKEP duhet të udhëhiqet nga parimet themelore që janë: ligjshmëria, transparencja, mosdiskriminimi dhe profesionalizmi. Ky seksion do të përgatitet në formën e një guide nga specialistët e AKEP.

KREU IV

DIPOZITA PERFUNDIMTARE DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 15

Detyrimi i sipërmarrësve ndaj përdoruesve

Sipërmarrësit janë të detyruar të pranojnë kërkesat dhe ankesat e përdoruesve mbi publikimin e tarifave. Me marrjen e kërkesës ose ankesës nga përdoruesi për publikimin e tarifave, sipërmarrësi është i detyruar të japë informacione dhe sqarime të hollësishme dhe të eliminojë keqkuptimet që mund të lindin lidhur me informimin për shërbimet e komunikimit dhe tarifat e tyre.

Neni 16

Konstatimi i shkeljeve, Kundërvajtjet administrative, gjobat, ankimimi

Konstatimi i shkeljeve, kundërvajtjet administrative, gjobat dhe ankimimi parashikohen në nenet 135, 136 dhe 137 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 17

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me Vendim të Këshillit Drejtues.